Zoti Ministër
Zonja dhe zotërinj
Profesorë dhe mjekë

Me kënaqësinë më të madhe dhe me krenari Ambasada e Francës është përfshirë në organizimin e kësaj konference mjekësore me temë "aksidentet cerebrovaskulare".
Në të vërtetë, pas suksesit të një konference mbi "Patologjinë e bazës së kafkës dhe hipofizës" në vitin 2011, ne zgjerojmë shkëmbimet tona tradicionale mes mjekësisë shqiptare dhe asaj franceze në fushën e përsosmërisë mjekësore falë përdorimit të video-konferencës, e cila bashkon kolegët tuaj shqiptaro-amerikan dhe shqiptarë të Kosovës. Unë jam e kënaqur nga ky zgjerim, i cili i jep një dimension rajonal dhe ndërkombëtar bashkëpunimit tonë çka pohon gjithashtu reputacion e shquar të mjekësisë shqiptare në botë, e gjallëruar në një masë të madhe nga praktikantë dhe profesorë të nxitur nga dashuri për vendin e tyre.

Që prej mbërritjes sime në Shqipëri, kam pasur disa herë rastin për të parë se si ju dhe shumë prej bashkatdhetarëve dhe kolegëve tuaj kanë ndjekur studimet e tyre në Francë. Më mbetet vetëm të shpresoj që rruga ku ju keni ecur dhe shembulli që ju jepni të frymëzojë brezat e rinj për të vazhduar këtë traditë.

Dua të falënderoj Profesorin Mentor Petrela për besnikërinë e tij ndaj miqësisë franko-shqiptare dhe që ka arritur të mbajë marrëdhënie mjaft të ngushta me kolegët e tij francezë sidomos në sajë të organizimit të konferencave, si kjo e sotmja, të cilat përbëjnë gjithmonë një ngjarje.

Me këtë rast, dëshiroj t'i bëj homazhe mjeshtrit të tij dhe profesorit, Raymond Houdart, anëtar i Akademisë së Mjekësisë, i cili që nga viti 1971 ka krijuar një ekip neurokirurgësh, neuroradiologësh dhe neurologësh, duke i hapur udhën qendrave të integruara. Sot, ndodhet mes nesh nipi i tij, Profesor Emmanuel Houdart, i cili ka marrë stafetën dhe vazhdon traditën familjare përfshirë këtu edhe miqësinë me Profesor Petrelën dhe me Shqipërinë.

Përshëndes gjithashtu praninë mes nesh në Tiranë të Profesorit Didier Payen, i cili ka ardhur këtu për herë të parë në vitin 1997 duke shoqëruar një ndihmë humanitare të organizuar nga Assistance Publique de Paris dhe që prej asaj kohe ka krijuar një ekip me anestezistë shqiptarë të formuar në Francë.

Jam e bindur se kjo ditë studimesh do të jetë e suksesshëm për ju, për pacientët në shërbim të të cilëve ju ofroni shkencën tuaj dhe natyrisht për miqësinë franko-shqiptare, ju uroj suksese.